



Prishtinë, 31 mars 2016
Kodi i ZRRE-së: V_805_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 19 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin për Autorizimin Final V-572-2013 të datës 24 tetor 2013 lëshuar shoqërisë "Eurokos JH" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC "Brodi II" (Mlik) me kapacitet të instaluar prej 3.89 MW, në lumin Brod dhe HC "Restelica I" dhe HC "Restelica II" (Krushevë) bashkohen në një objekt të hidrocentralit, me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, në Lumin Restelica, komuna e Dragashit.
- Kërkesën për modifikimin të Autorizimit Final për ndryshimin e kapacitetit gjenerues të HC Brodi II. (Mlike), nga kapaciteti fillestar i instaluar prej 3.89 MW në kapacitetin instalues 4.8 MW, në Lumin Brod, Komuna e Dragashit, të datës 19.11.2015 të shoqërisë "Eurokos J.H." SH.P.K. me adresë rruga 20 "Zenun Beqa", Ferizaj, Republika e Kosovës.
- Kërkesën për ndryshimin e kapacitetit gjenerues të HC Brodi II., sipas Lejes Ujore nr. 1782-3/ të datës 23.08.2012, drejtuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH); dhe
- Vendimin për ndryshimin e vendimit për Lejen Ujore me Nr. 1782-2/11 -ZSP-621, të datës 23.08.2012, për HC Brodi 2, të lëshuar nga MMPH, të datës 29.01.2016,

në seancën e mbajtur me datë 31 mars 2016 nxori këtë:

V E N D I M PËR MODIFIKIM TË AUTORIZIMIT FINAL

- I lëshohet **VENDIMI PËR MODIFIKIMIN E AUTORIZIMIT FINAL V-572-2013** i datës 24 tetor 2013, shoqërisë "Eurokos J.H." SH.P.K., për HC "Brodi II." (Mlik) për kapacitetin instalues nga **3.89 MW** në kapacitetin instalues **4.8 MW**, në Lumin Brod, komuna e Dragashit, sipas vendimit për ndryshimin e vendimit për Lejen Ujore me Nr. 1782-2/11 -ZSP-621, të datës 23.08.2012, të lëshuar nga MMPH, të datës 29.01.2016.

Arsyetim

- o ZRRE me datë 29.09.2011 nga shoqëria "Eurokos J.H." SH.P.K., ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 9.33 MW që përbëhet prej gjashtë (6) njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC "Brod I" (Brod) 1062 kW; HC "Brod II" (Dikance) 1250 kW; HC "Brod III"(Kukalane) 3120 kW; (totali 5432 kW) dhe HC "Restelica I" 1200 kW; HC "Restelica II" (Krushevë) 1200 kW dhe HC "Restelica III" (Globoqicë) 1498 kW (Totali 3898 kW), të gjitha në komunën e Dragashit.




- ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, me datë 10 shkurt 2012 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_395_2012, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
 - ZRRE me datë 07.08.2013 ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji në Autorizim për dy (2) njësit gjeneruese HC "Brodi II." me kapacitet prej 1.25 MW dhe HC "Restelica II" me kapacitet prej 1.2 MW, duke i bashkangjitur dëshmitë relevante.
 - ZRRE me datë 21.10.2013 ka pranuar kërkesën me ndryshime për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, për HC "Brod II" me ndryshim të kapacitetit të instaluar nga 1.25 MW në 3.89 MW dhe HC "Restelica I" dhe II, të cilat janë bashkuar në një objekt të hidrocentralit me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtat mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin ujit, Lejet ndërtimore dhe kërkesat tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
 - ZRRE me datë 24 tetor 2013 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V-572-2013 të datës 24 tetor 2013 shoqërisë "Eurokos JH" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC "Brodi II" (Mlik) me kapacitet të instaluar prej 3.89 MW, në lumin Brod dhe HC "Restelica I" dhe HC "Restelica II" (Krushevë) bashkohen në një objekt të hidrocentralit, me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, në Lumin Restelica, komuna e Dragashit.
 - ZRRE me datë 19.11.2015 ka pranuar kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final për ndryshimin e kapacitetit gjenerues të HC Brodi II. (Mlike), nga kapaciteti fillestar i instaluar prej 3.89 MW në kapacitetin total të instaluar në 4.8 MW, në Lumin Brod, Komuna e Dragashit.
 - ZRRE me datë 02.02.2016 ka pranuar nga shoqëria "Eurokos JH" sh.p.k. vendimin për ndryshimin e vendimit për Lejen Ujore me Nr. 1782-2/11 –ZSP-621, të datës 23.08.2012, për HC Brodi 2, të lëshuar nga MMPH, të datës 29.01.2016.
 - ZRRE me datë 14.03.2016 nga shoqëria Eurokos JH sh.p.k., ka pranuar kërkesën në lidhje me rritjen e kapaciteteve të HC Brodi II. nga 3.89 MW në 4.8 MW, duke i paraqitur arsyet e një ndryshimi të tillë, të kapaciteteve instaluese.
 - ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës për Modifikim të Autorizimit dhe dëshmime të bashkangjitura dhe pranimit të vendimit për ndryshimin e vendimit për Lejen Ujore, të kërkuara nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. **Obligohet** shoqëria "Eurokos JH" SH.P.K., që pas Pranimit Teknik të HC Brodi II., të sjell Certifikatën e Përdorimit të lëshuar nga Organi kompetent, dhe Lejen për Shfrytëzim Ujor të lëshuar nga MMPH.
- III. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.





IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Erver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar,


Arsim Janova, anëtar,


Qemajl Mustafa, anëtar,


Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Dragashit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.